

VENDIM
Nr.24, datë 20.1.1997

**PËR PËRDORIM FONDESH BUXHETORE PËR BLERJE BANESASH PËR ISH-TË
PËRNDJEKURIT POLITIKË**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nga fondet e Buxhetit të Shtetit të tremujorit të parë të vitit 1997 të Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, të akordohen për Entin Kombëtar të Banesave 49.9 milionë lekë për blerje banesash për ish-të përndjekurit politikë.

2. Përdorimi i këtij fondi do të bëhet në bazë të listave të paraqitura nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.

3. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave për blerjen e banesave me fondet e akorduara për ish-të përndjekurit politikë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.160, datë 3.4.1995 "Për kriteret e blerjes dhe të shitjes të apartamenteve nga Enti Kombëtar i Banesave në tregun e lirë të banesave".

4. Prokurimi për blerjen e banesave nga Enti Kombëtar i Banesave të kryhet me procedurën e tenderit të hapur, duke e ulur afatin kohor nga 30 në 15 ditë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Enti Kombëtar i Banesave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi